

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm,** përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit A.B. nga fshati ..., K....., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 275 parag.2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm PP.LL.nr.1626/17 e datës 14.09.2017, të cilën e përfaqësonte prokurorja Bahtije Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor kryesor, oral dhe publik, më datën 25.02.2018, mori dhe shpalli këtë :

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri **A.B.**, nga babai S. dhe nëna Xh. e lindur H., i lindur më data e lindjes..., në ..., me vendbanim në fshatin ..., K. ... i pamartuar, e ka të kryer shkollen fillore, i papunë, i gjendjes së varfer ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **Është fajtor**

-Më datë ..., rreth orës 22.00 minuta, në ... tek parku i qytetit pa autorizim ka poseduar sasinë prej 0.5 gramëve të substancave narkotike të llojit “ ... ” dhe 2 (dy) pilula tramadol të 50 mg, në atë mënyrë që mariuhanën e kishte futur në një qese dhe e kishte mbajtur në xhep së bashku me një thikë dhe pilulat e lartpërmendura derisa ishte vërejtur nga oficerët e policisë, me ç’rast mariuhanën e hedh në tokë kur i vëren oficerët e lartpërmendur, kurse thikën dhe tramadolin i mban në xhep derisa kontrollohet nga oficerët e lartpërmendur të cilat më pas edhe i sekuestrohen.

- me këtë ka kryer veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 par.2 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21,49,50,51,52,69 e 73 të KPRK, si dhe nenit 365 e 451 të KPP, të pandehurit i shqipton :

**DËNIM KUMULATIV TE KUSHTEZUAR ME BURGIM DHE ME GJOBË**

*Ashtu që të pandehurit A.B., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Eurove si dhe dënim me burgim në gjatësi prej 3 (tre) muajve, të cilat dënime ai nuk do ti paguaj gjegjësisht nuk do ta mbajë, nëse ai nuk kryen veprën tjetër penale në afatin prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajve pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.*

*Po ashtu atij do ti shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës së gjetur narkotike.*

*Obligohet i pandehuri që t'i paguaj 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit A.B., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 parag.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.*

*Në fillim të shqyrtimit gjyqësor të datës 25.02.2018, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri A.B., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.*

*Gjykata, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit dhe të konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.*

*Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :*

*Se i pandehuri A.B. ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 parag.2 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

*Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të pandehurin A.B., nga fshati ... K. ..., për shkak të veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 par.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.*

*Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit A.B., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese, pos gjetjes së substancës narkotike të i njëjti.*

*Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit të kushtëzuar me gjobë dhe burgim ndaj të pandehurit A.B., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi dënimin plotësues është i bazuar në nenin 62 e 69 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.*

*Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i përgjithshëm**

**Më 25.02.2017**

**Zyrtarja ligjore,  
Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Ramiz Azizi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.